TRAINKOS SH.A.
TRAINKOS D.D.
TRAINKOS J.S.C.
Nr.No.Br. 1/53
Dt. 17.03.2015
Fushë Kosovë - Fushë Kosova - Kosovo Polje

RAPORT VJETOR 2014

Vendimi: Nr. 1/53

Bordi i Drejtorëve i HK "Trainkos" Sh.A njëzëri miratoi Raportin Vjetor për vitin 2014 në mbledhjen Nr. 52 të mbajtur me datë 13.03.2015

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri:	**Gelor Shala** **Kryeshef Ekzekutiv**	**Heset Cakolli** **Kryesuesi i BD**
Nënshkrimi:		
Data:	**13.02.2015**	**13.03.2015**

HEKURUDHAT E KOSOVËS - TRAINKOS SH.A

RAPORT VJETOR 2014



PËRMBAJTJA:

1. Hyrje 3

2. Raport i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve..... 4
   - 2.1. Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes..... 4
   - 2.2. Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenten.....7
   - 2.3. Të dhënat për drejtorët jo-ekzekutiv.....7
   - 2.4. Komitetet e Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A..... 8

3. Raport i Kryeshefit Ekzekutiv..... 11
   - 3.1. Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv..... 11
   - 3.2. Ngjarjet kryesore të vitit..... 13
   - 3.3. Pasqyra e performancës operative..... 14
   - 3.4. Pasqyra e performancës financiare dhe rezultatet..... 21
   - 3.5. Progresi me planin e biznesit.....26
   - 3.6. Projektet kapitale 27
   - 3.7. Perspektiva për vitin e ardhshëm.....28
   - 3.8. Rreziqet e të ardhmes së korporatës..... 29

4. Raporti sipas Ligjit mbi Ndërmarrjet Publike.....30
   - 4.1. Struktura organizative e Trainkos Sh.A.....30
   - 4.2. Kontestet gjyqësore në periudhën janar-dhjetor 2014..... 32
   - 4.3. Kontestet gjyqësore të pritura në vitin 2015.....32
   - 4.4. Transaksionet e realizuara..... 34
5. Përfundim..... 35

6. Aneks Raporti
   - 6.1. Raport lidhur me sponsorimet dhe donacionet
   - 6.2. Raport Vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2014
   - 6.3. Raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve

1 HYRJE

Gjatë gjithë viti 2014 kompania kishte një ecuri progresive të realizimit të planit operativ dhe financiar. Progresi ka qenë rezultat i palodhshëm i krejt ekipit të Hekurudhave të Kosoves - Trainkos Sh.A. Vitin 2014, kompania e filloi me dokumentacionin bazë të kompletuar (Planin e Biznesit, Planin e Buxhetit dhe të gjitha politikat tjera të përcaktuara), mbi bazën e të cilave është zhvilluar aktiviteti dhe puna e kompanisë.

Ky raport i punës për vitin 2014, ku përfshihet aktiviteti i Ndërmarrjes Publike HK-Trainkos Sh.A do të filloj me fjalën e Kryesuesit të BD, i cili bart në vete performancën e kompanisë bashkë me aktivitetet e saj. Raporti i Kryesuesit ofron informacione edhe në lidhje me kapitalin e kompanisë dhe politikat ndikuese në zhvillimin e biznesit të saj. Trainkos Sh.A edhe pse një kompani e re publike vijoi të kryejë funksionin e saj të përshkruar me ligj krahas konsolidimit dhe ngritjes së kapaciteteve të veta njerëzore e materiale. Në këtë vit kompania ngriti kapacitetet e infrastrukturës së nevojshme ligjore dhe menaxhuese bashkë me ngritjen e mekanizmave tjerë të kontrollit.

Në vazhdim raporti vijohet nga raporti i Kryeshefit Ekzekutiv, duke ofruar me këtë rast të dhëna për ngjarjet kryesore për periudhën raportuese, të dhënat për performancën operative e financiare dhe progresin në drejtim të realizimit të Planit të Biznesit. Kur jemi te progresi drejt realizimit të planit të biznesit, raporti ofron të dhëna të detajuara për shpenzimet, investimet kapitale të kompanisë dhe gjithashtu një elaborim të çështjes së perspektivës bashkë me rreziqet e mundshme ndikuese. Po ashtu brenda raportit është paraqitur edhe skema organizative e stafit të kompanisë, ndryshimet e ndodhura gjatë kësaj periudhe si dhe një pjesë e raportit i është kushtuar çështjeve të ndryshme të lidhura me kontestet gjyqësore. Për të qenë raporti sa më i qartë dhe i kompletuar, brenda tij janë përfshirë edhe grafikone, tabela statistikore e skema tjera me sqarime të nevojshme.

Gjatë realizimit të këtij raporti, për të pasqyruar aktivitetet e kompanisë, suksesin e saj në realizimin operativ e financiar, gjithsesi që jemi bazuar në udhëzuesin në lidhje me hartimin e raportit vjetor dhe në Ligjin për NP.

Raporti Vjetor 2014 i HK-Trainkos Sh.A ka të bashkëngjitur edhe shtojcën apo Aneksin 1, i cili përmban të dhëna tjera shtesë të cilat mbesin për përdorim të aksionarit. Në këtë pjesë janë përfshirë raporti lidhur me sponsorimet dhe donacionet, raport vjetor i Zyrës së Auditimit të Brendshëm për vitin 2014 dhe raporti i vetëvlerësimit të Bordit të Drejtorëve.

2 RAPORT I KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE

Të nderuar aksionarë,

Bordi i Përkohshëm i Drejtorëve të Hekurudhave të Kosovës - Trainkos Sh.A. edhe gjatë vitit 2014 ka vazhduar punën e tij me përkushtim të lartë që ndërmarrja të konsolidohet sa më mirë dhe të arrij rezultatet e planifikuara. Përmbushja e obligimeve dhe përgjegjësive ligjore ka qenë fokusi kryesor i Bordit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 04/L-111 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe Ligjin për Shoqëritë Tregtare (Nr. 02/L-123), Bordi i Drejtorëve i Trainkos Sh.A, në emër të aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin edhe nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të. Hartimi i politikave dhe dokumenteve tjera strategjike për kompaninë si dhe mbikëqyrja e vazhdueshme në zbatimin e tyre ka qenë fokusi kryesor i BD për një qeverisje korporative të ndërmarrjes.

Në saje të këtij angazhimi të të gjithë drejtorëve të bordit nuk kanë munguar as sukseset në përmbushjen e obligimeve.

Në vijim, në këtë raport-vështrim do të paraqesim të dhënat mbi aktivitetet, performancën e ndërmarrjes dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vitin 2014.

2.1. AKTIVITETET DHE PERFORMANCA E NDËRMARRJES

Ky raporti për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A për vitin 2014 pasqyron të dhënat për performancën e ndërmarrjes si dhe sfidat më të cilat jemi ballafaquar. Viti 2014 është përmbyllur me një rezultat të kënaqshëm operativ e financiar.

Sfidat me të cilat u ballafaquam edhe gjatë vitit 2014 ishin të ndryshme. Përderisa është rregulluar çështja e pagesave të qasjes në binarë, ende kanë mbetur shumë çështje tjera të pazgjidhshme. Mbulimi i shpenzimeve të transportit të udhëtarëve ende vazhdon të mos bëhet ashtu siç është e definuar me Ligjin për Hekurudhat e Kosovë. Madje, këtu kemi edhe ngecje në raport me periudhat paraprake. Këtë vit kemi pasur edhe zvogëlim të kësaj shume. Kjo pikë do të jetë sfiduese edhe në të ardhmen dhe paraqet njërin prej shkaqeve më ndikuese në performancën dhe zhvillimin e ndërmarrjes.

Kostoja e shpenzimeve të qasjes në binarë për menaxherin e infrastrukturës hekurudhore Infrakos SH.A ka qenë e njëjtë sikurse ajo e vitit të kaluar dhe ende këto pagesa vazhdojnë të jenë më të lartat në rajon edhe pse në një përqindje të vogël. Këto tarifa kanë qenë vështirë të përballueshme për ne, të cilat na kanë shtyrë në reduktimin e shpenzimeve si në aspektin operues ashtu edhe në atë administrativ.

Kompletimi me dokumente strategjike e ligjore, mbi bazën e të cilave zhvillohet aktiviteti i ndërmarrjes së Hekurudhat e Kosoves - Trainkos Sh.A gjithashtu ka qenë fokus i Bordit dhe menaxhmentit që t'i përmbushim këto obligime.

- **Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2014**

Përkushtimi kryesor i Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2014 ka qenë arritja e caqeve të përcaktuara në Planin e Biznesit për këtë vit. Falë angazhimit të përbashkët me stafin e kompanisë kemi arritur që të tejkalojmë këto objektiva. E vetmja ngecje në realizimin e këtyre objektivave ka ndodhur te të hyrat nga Ministria e Infrastrukturës për shpenzimet në transportin e udhëtarëve, përkatësisht të hyrat nga marrëveshja për Obligimet e Shërbimeve të Përbashkëta - OSHP.

Hartimi i politikave të kompanisë ka vazhduar edhe gjatë vitit 2014. Janë nxjerrë një serë rregulloresh të cilat definojnë shumë procedura e çështje të brendshme të organizimit të punëve si dhe të transportit.

Ndërsa, duhet theksuar se ne u përkushtuam edhe në realizimin e objektivave në fushën e bashkëpunimit me institucionet vendore e ndërkombëtare, ku mund të themi me përgjegjësi se kemi arritur të avancojmë jashtëzakonisht shumë në ndërtimin e një bashkëpunimi shumë domethënës në këtë drejtim. Si rezultat i këtij bashkëpunimi kemi përfituar një projekt nga qeveria Holandeze për trajnimin e stafit ekzekutiv (makinistë, ndihmës makinistë/udhëheqës treni, frenues manovrues si dhe për stafin e mirëmbajtjes). Ky projekt do të realizohet për një periudhë 4 vjeçare dhe ka një vlerë prej 548,444.80 €.

- **Pasqyra e performancës operative dhe financiare në krahasim me vitin paraprak dhe planin e vitit aktual**

Gjatë vitit 2014 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. kanë pasur një rezultat të mirë operativ e financiar, sidomos në transportin e mallrave. Por, realizimi financiar në transportin e udhëtarëve ende ka mbetur i paarritshëm për shkak të mosmbulimit të shpenzimeve nga ana e Qeveris se Republikës se Kosovës ashtu siç është paraparë me Ligjin për Hekurudhat e Kosovës.

- **Transporti i Mallrave**

Performanca operative në transportin e mallrave, sikurse është e pasqyruar edhe në pjesën tabelare por edhe përshkruese të këtij raporti, është për 5 % neto ton mallra të transportuara më pak se sa planifikimi, apo për 16 % më pak se realizimi gjatë vitit 2013. Por, duke pasur parasysh edhe numrin e kontejnerëve të transportuar gjatë vitit 2014 del se ne e kemi arritur planifikimin e paraparë për vitin 2014. Janë transportuar 1018 kontejnerë të plotë si dhe 38 të tjerë të zbrazur, të cilët hyjnë në transportin e mallrave. Performanca financiare nga transporti i mallrave është për 4.45 % më shumë se sa planifikimi vjetor i planifikuar për vitin 2014, mirëpo krahasuar me vitin paraprak 2013 është më pak për 13.84 %. Shikuar në tërësi realizimi i planifikimit në total është tejkaluar. Këto të dhëna janë prezantuar ndaras; në të hyra nga kontejnerët dhe të hyrat tjera (mirëmbajtja e vagonëve të mallrave dhe RIV-i që janë të planifikuara në ketë kategori).

- **Transporti i Udhëtarëve**

Përformanca operative në numrin e udhëtarëve në këtë kategori transporti është më pak për 4.69 % në krahasim me vitin paraprak si dhe për 8.16 % më pak se sa planifikimi për vitin 2014. Sa i përket realizimit financiar në transportin e udhëtarëve nga shitja e biletave kemi pasur një rritje prej 5.81 % të të hyrave krahasuar me planifikimin, ndërsa krahasuar me vitin 2013 janë realizuar të hyrat prej 3.02 % më shumë. Përkundër kësaj, shpenzimet e qarkullimit të trenave të udhëtareve ende mbeten të pambuluara ashtu siç e parasheh Ligji për Hekurudhat dhe për këtë arsye humbjet nga transporti i udhëtarëve për vitin 2014 janë - 476,831.85 € apo - 21 %.

- **Ngjarjet të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes**

Sfidat për vitin në vijim mbeten sfidat për plotësimin e politikave (rregulloreve) bazike, për të cilat padyshim se duhet angazhim shtesë edhe i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave - ARH, Ministrisë së Infrastrukturës dhe institucioneve tjera, të cilat kanë përgjegjësinë e caktuar në këtë drejtim.

Një ndër sfidat kryesore për kompaninë Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A mbetet modernizimi i parkut të mjeteve lëvizëse duke pasur parasysh numrin e vogël të këtyre mjeteve që kemi në dispozicion por edhe vjetërsinë e tyre te cilat përveç shpenzimeve të larta për mirëmbajtje kanë edhe shpenzime tjera operuese të cilat ndikojnë drejtpërdrejt ne rritjen e kostos se përgjithshme.

Vlen të theksohet se kjo gjendje e mjeteve lëvizëse që kemi në parkun tonë është si rezultat i buxhetit të vogël të ndarë nga ana Qeverisë së Republikës së Kosovës për Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. Mjetet e ndara gjer më tani për projektet kapitale kanë qenë tejet të vogla gjë që kanë ndikuar në dështimin e projekteve kapitale për dy vite radhazi. Shpresojmë se shuma e ndarë për investime kapitale në vitet e ardhshme do të jetë më e lartë.

Po ashtu, sfidë e vazhdueshme mbetet përpilimi dhe hartimi i politikave strategjike për zhvillim të kompanisë. Në këtë kontekst, BD është i përkushtuar të ndërmarrë nismat që janë në përgjegjësi të tij, që projekteve paraprake t'u japë shtytje për realizim.

Struktura e stafit do të jetë sfidë më vete; siç është përtëritja e tij, ku mosha mesatare e punëtorëve është tejet e lartë dhe përmirësimi i strukturës gjinore e profesionale.

Gjithashtu vlen të theksohet se shërbimet e veçanta që ofrojmë kërkojnë edhe përgatitje profesionale të veçantë. Andaj, fokus i angazhimeve tona do të jetë përgatitja e kuadrove, qoftë përmes ndonjë iniciative për hapje të drejtimeve shkollore përkatëse në Kosovë, apo edhe përmes trajnimit dhe certifikimit nga institucione e organizata ndërkombëtare relevante. (Për këtë të fundit, kemi zhvilluar një mori takimesh e negociatash, por realizimi i këtij synimi kërkon kosto jo të vogël).

- **Të priturat për vitin e ardhshëm**

Një prej synimeve tona, padyshim që është planifikimi i investimeve në modernizimin e mjeteve lëvizëse dhe, pse jo, në blerjen e mjeteve të reja. Për ketë jemi të vetëdijshëm se është një mision i vështirë, por me ndihmën e aksionarit dhe me ato pak mundësi tona financiare, pa lënë anash edhe mundësinë për gjetjen e donatorëve, ku kemi realizuar shumë takime dhe jemi në negociata me disa mekanizma ndërkombëtarë për të siguruar donacione apo forma tjera të përshtatshme dhe të leverdishme për investime në modernizim dhe avancim teknologjik, shpresojmë se do të kemi sukses.

Synim tjetër, mbetet rritja e transportit të mallrave si dhe rritja e të hyrave nga transporti i udhëtarëve. Në këtë drejtim, presim që të rrisim numrin e udhëtarëve në transport, dhe mbesim me shpresë dhe mirëkuptimin e ministrisë përkatëse me rastin e nënshkrimit të marrëveshjes për shërbime të përbashkëta (Obligimet e Shërbimeve te Përbashkëta –OSHP) konform kërkesave ligjore të parapara në Ligjin e Hekurudhave.

Si përfundim, nëse shikojmë trendin e zhvillimit të kompanisë, vitin 2014 do ta quajmë vit të ndërtimit e të zhvillimit të qëndrueshëm të ndërmarrjes. Ndërsa, së bashku do angazhohemi që vitin 2015, me punë dhe rezultate, ta pagëzojmë si vitin model të zhvillimit dhe avancimit të Hekurudhave të Kosovës Trainkos Sh.A.

2.2. INFORMACIONE LIDHUR ME KAPITALIN DHE DIVIDENTEN

Projektet e vitit paraprak, riparimi gjeneral i një lokomotive, gjatë vitit 2014 nuk është realizuar nga fakti se procedurat e tenderimit të vazhdueshëm nuk kanë nxjerrë një fitues për procedim të mëtejm. Kjo, ka ardhur edhe si pasojë e procedurave ligjore por edhe për shkak se fondi i ndarë për projekte kapitale ka qenë tejet i vogël. Shuma e Donacionit nga Buxheti i Kosovës prej 1,238,842.00€ për projektet kapitale të parashikuara në vitin 2014 nuk është shfrytëzuar përderisa kemi të bëjmë me mjete shumë të kushtueshme në treg.

Një e dhënë tjetër që duhet theksuar është edhe fakti se Hekurudhat e Kosoves - Trainkos Sh.A. gjatë këtij viti nuk ka nënshkruar asnjë marrëveshje kredituese gjë e cila na bën të ndihemi mirë pasi që ndërmarrjen nuk e kemi futur në asnjë borxh gjë e cila do të ndikonte negativisht në zhvillimet e mëtejme.

Ndërsa sa i përket ndarjes së **dividentës**, kompania nuk ka arritur atë nivel të performancës së vet për të realizuar atë ashtu siç është e paraparë me aktet juridike të cilat rregullojnë këtë çështje.

2.3. TË DHËNAT PËR DREJTORËT JO-EKZEKUTIVË

Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A është emëruar me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës me Nr. 04/24 të datës 20.07.2011, ndërsa me Vendimin tjetër të Qeverisë me Nr. 27/53 të datës 21.12.2011 i është vazhduar mandati deri në përzgjedhjen e Bordit të ri. Në bazë të këtij vendimi si dhe të Ligjit për Ndërmarrjet Publike, Bordi i Drejtorëve në emër të Aksionarit ka ushtruar kompetencat e veta në përmbushjen e detyrave dhe obligimeve që dalin nga ligjet tjera të aplikueshme për NP-të.

Gjatë vitit 2014 Bordi i Drejtorëve i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A ka mbajtur gjithsej 12 mbledhje. Po ashtu edhe konsultat dhe kontaktet tjera midis drejtorëve të Bordit dhe menaxhmentit të kompanisë kanë qenë të shpeshta. Gjithashtu edhe Mbledhja e Përgjithshme Vjetore me Aksionarin është mbajtur sipas afatit të paraparë.

Më datë 14.10.2014, Kryesuesi i Bordit z.Hasan Ibraj, ka paraqitë dorëheqje nga pozita e tij, pas një kërkese të Agjencionit Kundër Korrupsionit për shmangie nga konflikti i mundshëm i interesit. Ndërsa, më 22.10.2014, Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonimik në këtë pozitë ka emëruar z. Heset Cakolli, i cili nga kjo datë ushtron këtë detyrë.

Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Bordit, numri i mbledhjeve të mbajtura gjatë vitit 2014 si dhe pjesëmarrja e drejtorëve në këto mbledhje:

Përbërja e Bordit të Drejtorëve të HK Trainkos Sh.A			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Hasan Ibraj	Kryesues deri më 22.10.2014	8
2	Heset Cakolli	anëtar/ Kryesues pas 22.10.2014	12
3	Labinot Halilaj	anëtar	12
4	Shkumbin Hyseni	anëtar	12
5	Betim Gjoshi	Kryeshef Ekzekutiv	12
6	Afrim Kuleta	Sekretar	12

2.4 KOMITETET E BORDIT TË DREJTORËVE TË TRAINKOS SH.A

Me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore dhe arritjes së performancës së kompanisë, punën e Bordit të Drejtorëve e kanë ndihmuar edhe komitetet e krijuara nga vetë Bordi si dhe Komisioni i Auditimit i cili është formuar nga Aksionari. Disa prej komiteteve të BD, pasi që është vlerësuar se nuk janë të domosdoshme, ato edhe janë shpërberë, por në ndërkohë janë krijuar edhe komitete të reja për çështje të caktuara të cilat kanë kërkuar trajtim më specifik.

Duhet theksuar se në muajin gusht 2014, bazuar në kërkesën e NJPMNP dhe në ndryshimet e bëra në Kodin e Etikës, është bërë riorganizimi i komiteteve. Fillimisht është marrë vendim për shuarjen e të gjitha komiteteve dhe pas vlerësimit të përbashkët janë krijuar komitetet e reja.

Pas dorëheqjes së Kryesuesit të Bordit dhe zëvendësimit të tij nga z. Heset Cakolli, i cili ka qenë anëtar i Komisionit të Auditimit, mbledhjet dhe puna e Komisionit është zhvilluar me dy anëtarë. Po ashtu këto ndryshime në strukturën e Bordit kanë ndikuar edhe në strukturën e komiteteve, të cilat gjithashtu kanë zhvilluar punën e tyre në mungesë të një anëtari.

Gjatë vitit 2014 kanë funksionuar gjithsej tetë komitete të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A, si dhe Komisioni i Auditimit. Por, jo të gjitha komitetet kanë qenë aktive njëkohësisht.

Në pjesën në vijim do të pasqyrohen komitetet që kanë funksionuar gjatë vitit 2014:

Nr	KOMITET AKTIVE	Data e formimit	Data e shpërbërjes
-	Komisioni i Auditimit	07.09.2011	Aktiv
1	Komiteti për Staf dhe Shpërblime	30.07.2014	Aktiv
2	Komiteti për Projekte Kapitale	30.07.2014	Aktiv
3	Komiteti i Financave	30.07.2014	Aktiv
KOMITETET E SHPËRBËRA			
1	Komiteti për Staf dhe Shpërblime	25.08.2011	30.07.2014
2	Komiteti për Projekte Kapitale	23.10.2012	30.07.2014
3	Komiteti i Financave	30.05.2013	30.07.2014
4	Komiteti për Transportin e Udhëtarëve	04.02.2013	30.07.2014
5	Komiteti për Politikat e Sigurisë dhe Akteve tjera Normative	30.05.2013	30.07.2014

Kontributi i komiteteve ka qenë tejet i rëndësishëm në definimin e shumë çështjeve dhe lehtësimin e punëve të Bordit. Në pjesën në vijim të këtij raporti do të paraqesim një përshkrim të shkurtër për përbërjen e këtyre komiteteve, datën e formimit apo shpërbërjes si dhe numrin e takimeve të mbajtura gjatë vitit 2014:

Komisioni i Auditimit i Hekurudhave të Kosovës-Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Aksionarit Nr. 01/159 më datë 07.09.2011. Gjatë vitit 2014 Komisioni ka mbajtur gjithsej 11 mbledhje. Në bazë të vendimit Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nr. 1912 të datës 22.10.2014, z. Heset Cakolli, është emëruar si U.D i Kryesuesit të Bordit. Nga kjo datë z. Cakolli nuk ka qenë më pjesë e Komisionit të Auditimit pasi që në bazë të Ligjit për NP Kryesuesi i Bordit nuk mund të jetë anëtar i Komisionit të Auditimit.

Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komisionit:

Përbërja e Komisionit të Auditimit			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Labinot Halilaj	kryesues	**11**
2	Shkumbin Hyseni	anëtar	**11**
3	Heset Cakolli	Anëtar deri më 22.10.2014	**7**

Komitetet të cilat kanë funksionuar deri më 30.07.2014:

Komiteti për Staf dhe Shpërblime i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 25.08.2011 dhe ka funksionuar deri më 30.07.2014. Gjatë vitit 2014 Komiteti ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komiteti për Staf dhe Shpërblime			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Shkumbin Hyseni	kryesues	**4**
2	Hasan Ibraj	anëtar	**4**
3	Labinot Halilaj	anëtar	**4**

Komiteti për Projekte Kapitale i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 23.10.2012 dhe ka funksionuar deri më 30.07.2014 . Gjatë vitit 2014 Komiteti ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit për Projekte Kapitale			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Heset Cakolli	kryesues	**5**
2	Hasan Ibraj	anëtar	**5**
3	Shkumbin Hyseni	anëtar	**5**

Komiteti për Transportin e Udhëtarëve i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 04.02.2013 dhe ka funksionuar deri më 30.07.2014. Gjatë vitit 2014 Komiteti ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit për Transportin e Udhëtarëve			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Labinot Halilaj	kryesues	**4**
2	Shkumbin Hyseni	anëtar	**4**
3	Hasan Ibraj	anëtar	**4**

Komiteti i Financave i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 30.05.2013 dhe ka funksionuar deri më 30.07.2014. Gjatë vitit 2014 Komiteti ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit të Financave			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Hasan Ibraj	kryesues	**4**
2	Labinot Halilaj	anëtar	**4**
3	Heset Cakolli	anëtar	**4**

Komiteti për Politikat e Sigurisë dhe Akteve tjera Normative i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 30.05.2013 dhe ka funksionuar deri më 30.07.2014 . Gjatë vitit 2014 Komiteti ka mbajtur gjithsej 4 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit për Politikat e Sigurisë dhe Akteve tjera Normative			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Shkumbin Hyseni	kryesues	3
2	Labinot Halilaj	anëtar	4
3	Hasan Ibraj	anëtar	3
4	Heset Cakolli	anëtar	3

- **Në pjesën në vijim janë pasqyruar komitetet të cilat më rastin e rishikimit dhe të riorgaanizimit të tyre kanë funksonuar nga data 30.07.2014:**

Komiteti për Staf dhe Shpërblime i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 30.07.2014. Pas formimit e deri më 31.12.2014 Komiteti ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komiteti për Staf dhe Shpërblime			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Shkumbin Hyseni	kryesues	**5**
2	Labinot Halilaj	anëtar	**5**
3	Hasan Ibraj	anëtar	**2**

Komiteti për Projekte Kapitale i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë më 30.07.2014. Pas formimit e deri më 31.12.2014 Komiteti ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit për Projekte Kapitale			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Heset Cakolli	kryesues	**5**
2	Shkumbin Hyseni	anëtar	**5**
3	Hasan Ibraj	anëtar	**2**

Komiteti i Financave i Trainkos Sh.A është formuar me vendim të Bordit të Drejtorëve më datë 30.07.2014. Pas formimit e deri më 31.12.2014 Komiteti ka mbajtur gjithsej 5 mbledhje. Në tabelën në vijim paraqitet përbërja e Komitetit:

Përbërja e Komitetit të Financave			
Nr.	**Emri dhe Mbiemri**	**Pozita**	**Pjesëmarrja në mbledhje**
1	Hasan Ibraj	kryesues	**2**
2	Labinot Halilaj	anëtar	**5**
3	Heset Cakolli	Anëtar (Kryesues)	**5**

Sqarim: Pas dorëheqjes së z. Hasan Ibraj nga pozita e Kryesuesit të BD dhe vendimit të Ministrit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik nr. 1912, të datës 22.10.2014 për emërimin e z. Heset Cakolli në pozitën e U.D të Kryesuesit të Bordit, më datë 27.10.2014 në Mbledhjen nr. 46, Bordi i Drejtorëve ka marrë vendim që: Deri në një vendim të ri të Bordit të Drejtorëve komitetet në të cilat Hasan Ibraj ka qenë anëtar do të vazhdojnë punën e tyre me mungesë të një anëtari. Ndërsa, në komitetin të cilin z. Ibraj ka qenë Kryesues, ai do të zëvendësohet nga Kryesuesi i Bordit, i cili njëkohësisht është edhe anëtar i këtij komiteti.

Në emër të Bordit të Drejtorëve të Trainkos Sh.A
Heset Cakolli – Kryesues

3 RAPORT I KRYESHEFIT EKZEKUTIV

3.1 FJALA E KRYESHEFIT EKZEKUTIV

Viti që lamë pas (2014) ka qenë vit i suksesshëm, duke u bazuar gjithmonë në realizimin e objektivave që kanë dalë nga Plani i Biznesit dhe përmbylljen me fitime të vitit. Ky sukses në radhë të parë i atribuohet angazhimit maksimal të të gjithë strukturës organizative duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, Menaxhmenti e deri tek pjesa e stafit operativ.

Viti 2014, karakterizohet me vazhdimin e traditës nga viti i kaluar, me stabilitet financiar, kujdes në shpenzime, rritje e masave të kontrollit dhe përdorim racional të të gjitha resurseve, këto janë veprimet kryesor që kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në arritjen e një performance të mirë për vitin 2014, që rezulton profitabile për kompaninë.

Në kemi përmbyllur vitin 2014 më një bilanc pozitiv, duke përmbushur realizimin e objektivave të përcaktuara me planin e biznesit 2014. E vetmja ngecje në realizimin e objektivave ka ndodhur te të hyrat nga Ministria e Infrastrukturës për shpenzimet në transportin e udhëtarëve, përkatësisht të hyrat nga marrëveshja për Obligimet e Shërbimeve të Përbashkëta - OSHP.

Gjithmonë duke u bazuar në funksion të respektimit të ligjit, afateve ligjore dhe kërkesës së aksionarit kompania Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A. me kohë ka hartuar Planin e Biznesit, është pajisur me licencat e nevojshme të operimit nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) dhe në vazhdimësi ka raportuar tek aksionari mbi zhvillimet në kompani.

Në funksion të rritjes së efikasitetit duke respektuar parimet ligjore, kemi ndërtuar një strukturë organizative që ka ndikuar fuqishëm në arritjen e performancës pozitive dhe profitabile.

Është vazhduar puna dinamike në funksion të përshtatshmërisë ligjore të rregullave të brendshme me legjislacionin në fuqi, direktivat e Bashkimit Evropian dhe rregullat ndërkombëtare të operimit në transportin hekurudhor.

Kemi ndërtuar një ofertë të mirë për transport hekurudhor të mallrave dhe udhëtarëve, që ofron, siguri, saktësi dhe çmime të volitshme dhe konkurse të tregut. Në të njëjtën kohë jemi angazhuar maksimalisht që oferta jonë të arrijë te çdo klientë potencialë duke përdorur forma të avancuara të promovimit dhe shitjes duke shtuar kujdesin për konsumatorët e shërbimeve tona.

Përkundër performancës së mirë biznesore të kompanisë, stabilitetit financiar dhe angazhimeve maksimale të të gjithë strukturës organizative të kompanisë, gjatë vitit 2014 ashtu si edhe një vit më parë (2013), nuk kemi mundur të realizojmë procedurat për investime

kapitale. Kemi përsëritur disa herë tenderin për këto investime por nuk kemi arritur të kemi oferta të mjaftueshme serioze për të realizuar projektet tona.

Sfida kryesore për zhvillimin e gjithë biznesit të HK-Trainkos Sh.A. mbetet padyshim investimi në flotën e mjeteve lëvizëse (lokomotiva, vagonë dhe trena motorikë). Për shkak të gjendjes së mjeteve lëvizëse, vjetërsisë së tyre dhe amortizimit të tyre, kërkohen investime emergjente. Për të realizuar këtë duhet një fond mjetesh gjë që aktualisht nuk përballohet nga të hyrat vetanake dhe mjetet që ndahen nga aksionari për këtë qëllim. Investimet kapitale janë të domosdoshme dhe duhet të ndodhin në një kohë sa më të shkurtër në mënyrë që kompania të mos përballet me pamundësinë operative që të realizojë biznesin e saj.

Jemi të përkushtuar që të kemi angazhim maksimal për një zhvillim të gjithmbarshëm të kompanisë. Në kuadër të këtij përkushtimi do të kemi një plan afatmesëm strategjik për zhvillimin e kompanisë dhe ballafaqimin me rreziqet e natyrave të ndryshme të biznesit tonë, ku do të vendosen objektiva të qarta mbi mundësinë e zgjerimit të pakos së shërbimeve që ofron kompania, për kompletimin e flotës së mjeteve lëvizëse, për zgjerimin e linjave të transportit dhe do të vazhdojmë me veprime konkrete në kuptim të rritjes së efikasitetit organizativ të kompanisë.

Kryeshefi Ekzekutiv
Gelor Shala

3.2. NGJARJET KRYESORE TË VITIT

Janë të shumta ngjarjet që na kanë shoqëruar gjatë vitit 2014. Ndër çështjet me më rëndësi për këtë vit mund të veçojmë aplikimin e Deklaratës së Rrjetit, pra pagesat për qasje në rrjet dhe shërbime tjera që janë paguar duke u bazuar në këtë ekspoze.

Gjatë vitit 2014 është rritur niveli i bashkëpunimit me Autoriteti Rregullativ të Hekurudhave, ku kompania është pajisur me disa licenca dhe autorizime për shërbime të transportit hekurudhor që ofrojmë.

Po ashtu, edhe këtë vit është arrit marrëveshje me Ministrinë e Infrastrukturës për Obligimet e Shërbimeve te Përbashkëta - OSHP, edhe pse nuk i mbulon gjithë trenat siç e parasheh Ligji për Hekurudhat e Kosovës dhe kohëzgjatjen e marrëveshjes e cila duhet të jetë për një periudhën prej 3- deri në 5 vite.

Këtë vit përveç angazhimit për rritje të transportit kemi bërë përpjekje për anëtarësim në organizata ndërkombëtare dhe rritje të bashkëpunimit me hekurudhat tjera.

Kemi pasur takime me Hekurudhat Zvicerane – SBB, ato të Malit të Zi - Montecargo etj.

Këtë vit kemi fituar përmes Ambasadës Holandeze një projekt në programin MMF, nga i cili do përfitojmë konsulencë.

Kemi miratuar shumë akte, në mesin e tyre edhe Politikat e Sigurisë. Kemi bërë shumë përpjekje për t'u anëtarësuar në CIT, OTIF, CER etj. dhe shumë ngjarje tjera të cilat i kemi prezantuar edhe në raportet tjera periodike.

Gjatë këtij viti është vazhduar me proceset e parapara për koordinimin e aktiviteteve me institucionet tjera relevante për: certifikimin e makinistëve dhe licencimin e makinistëve, autorizimet për mjetet lëvizëse, përgatitjen e rregulloreve nacionale të sigurisë në bashkëpunim me Autoritetin Rregullativ Hekurudhorë (ARH) dhe Menaxherin e Infrastrukturës (MI), riregjistrimin e të gjitha mjeteve lëvizëse të cilave u janë marrë autorizimet për operim, inspektimi i mjeteve lëvizëse dhe ndarja dhe shtypja e targave të tyre si dhe raportimi i rregullt vjetor në CIT.

3.3 PASQYRA E PERFORMANCËS OPERATIVE E TRAINKOS SH.A

Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancën operative gjatë periudhës janar-dhjetor 2014, duke prezantuar realizimin operativ gjatë kësaj periudhe të vitit krahasuar me planifikimin për të njëjtën periudhë dhe me realizimin e vitit paraprak për të njëjtën periudhë. Po ashtu do të komentojmë ndryshimet që kanë ndodhur gjatë kësaj kohe.

- **Transporti i mallrave**

Në Sektorin e Transportit të Mallrave, i cili luan rolin kryesor për ne, gjatë periudhës një vjeçare respektivisht nga 1 janari 2014 deri më 31 dhjetor 2014 të shprehura në ton, kemi realizuar:

Përshkrimi – Sasia e Transportuar	Janar – Dhjetor 2014
Realizimi Neto Ton në 2013	**1,002,457.84 Ton**
Realizimi Neto Ton në 2014	**837,829.54 Ton**
Planifikimi Neto Ton në 2014	**878,961.21 Ton**
Dallimi: Realizim 2014 – Realizim 2013	**- 164,628.30 Ton**
Dallimi: Realizim – Planifikim në 2014	**- 41,131.67 Ton**
Dallimi: Realizim 2014 – Realizim 2013 (%)	**- 16 %**
Dallimi: Realizim 2014 – Planifikim 2014 (%)	**- 5 %**

Tabela 1.1

- Transporti i mallrave me kontejnera për këtë vit ka qenë:

Përshkrimi – Numri i Transportuar i kontonjerave	Janar – Dhjetor 2014
Kontonjera të plotë - 2014	**1,018 copë**
Kontonjera të zbrazët - 2014	**38 copë**

Tabela 1.2

- Siç mund të shihet nga tabela 2.1 në këtë periudhë kohore kemi transportuar për rreth 16 % më pak se sa në të njëjtën periudhë raportuese të vitit të kaluar si dhe rreth 5 % më pak se planifikimi për vitin 2014. Vlen të theksohet edhe numri i kontejnerëve të cilët janë paraqitur në tabelën 1.2 është dukshëm më mirë krahasuar me vitin e kaluar 2013.




Figura 1.1

- Siç mund të shihet nga figura 1.1 në aspektin operativ kemi një rritje të konsiderueshme nga planifikimi, e cila ka qenë për ketë periudhë raportuese duke pasur parasysh edhe numrin e kontejnerëve të transportuar gjatë vitit që po e lëmë pas.

Përshkrimi	Të hyrat në periudhën: Janar – Dhjetor 2014
Realizim shitje të hyra 2013	**3,034,457.72 €**
Realizim shitje të hyra 2014	**2,665,436.69 €**
Planifikimi 2014	**2,551,770.42 €**
Dallimi realizim 2014 - realizim 2013	**- 369,021.03 €**
Dallimi realizim – planifikim 2014	**113,666.27 €**
Dallimi realizim 2014 - realizim 2013 në %	**- 13.84 %**
Dallimi Realizim – Planifikim 2014	**+ 4.45 %**

Tabela 1.3




Figura 1.2

- Ndërsa, reflektimi financiar i transportit të mallrave, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore janë krijuar të hyra prej **13.84** % më pak se sa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë kohore raportuese dhe **4.45** % më shume se sa planifikimi për periudhën janar - dhjetor 2014.

- **Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti të mallrave**

Përshkrimi	Të hyrat dhe shpenzimet gjatë 2014
Shitjet nga transporti i mallrave	2,370,967.82
Të ardhura tjera nga transporti i mallrave	294,468.87
Total shitjet	**2,665,436.69**
Shpenzimet direkte në transportin e mallrave	1,440,451.00
Shpenzimet indirekte në transportin e mallrave	377,272.97
Total shpenzimet	**1,817,723.97**
Fitimi/humbja	**+ 847,712.72**
Fitimi/humbja operative në %	**+ 47 %**

Tabela 1.4




Figura 1.3

- Në shitjet nga shërbimet e tjera të transportit të mallrave hyjnë***:**

- ✓ Të ardhurat nga transportimi i kontejnerëve me vlerë: **82,060.00 €**
- ✓ Të ardhurat nga RIV dhe vendosja me vlerë: **87,134.93 €**
- ✓ Të ardhura tjera nga shërbime për klientin "Hib Petroll" me vlerë: **532.09 €**
- ✓ Të ardhura tjera nga riparimi i vagonëve me vlerë: **124,741.85 €**

- Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të mallrave ka operuar me një fitim operativ prej **47 %** gjatë periudhës raportuese.

Vërejtje: *Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për gjatë vitit 2014 duke marrë për bazë tren - kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e mallrave kanë operuar rreth 29 % nga totali i tren - kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.*

Transporti i udhëtarëve

- Në fushën e sektorit të transportit të udhëtarëve gjatë kësaj periudhe kohore kemi pasur rezultate jo shumë të kënaqshme.

- Në tabelën më poshtë janë paraqitur krahasimet e përgjithshme të të dhënave të realizuara në periudhën Janar - Dhjetor 2013 me periudhën e njëjtë të vitit 2014. Në këtë tabelë shihet se kemi rënie të numrit të udhëtarëve në këtë vit krahasuar me numrin e udhëtareve për vitin e kaluar por edhe me planifikimin e vitit 2014.

Përshkrimi - Udhëtarë	Numri i udhëtareve
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2013	**369,777**
Realizimi i numrit të udhëtarëve në 2014	**352,410**
Planifikimi i numrit të udhëtarëve në 2014	**381,198**
Dallimi: 2014 - 2013	**- 17,367**
Dallimi: realizim - planifikimi 2014	**- 28,788**
Dallimi: 2014 - 2013	**- 4.69 %**
Dallimi: realizim - planifikimi 2014	**- 8.16 %**

Tabela 2.1

- Siç shihet nga shënimet e paraqitura më lart, sa i përket transportit të udhëtarëve për këtë periudhë kohore kemi pasur një numër më të vogël të udhëtarëve krahasuar me vitin e kaluar apo 4.69 % më pak dhe 8.16 % kundrejt planifikimit. Vlen të theksohet se nuk kemi mekanizëm për përcaktimin e saktë të numrit të udhëtarëve që frekuentojnë transportin hekurudhor duke pasur parasysh edhe kategoritë e liruara.

- Në tabelën më poshtë është pasqyruar realizimi i transportit të udhëtarëve në vlera financiare:

Shitje e biletave	Të hyrat
Realizim shitje të hyra 2013	**243,131.16 €**
Realizim shitje të hyra 2014	**250,710.53 €**
Planifikimi 2014	**236,135.05 €**
Dallimi: realizim 2014 - realizim 2013	**7,579.37 €**
Dallimi: realizim - planifikim 2014	**14,575.48 €**
Dallimi: realizim 2014 - realizim 2013	**3.02 %**
Dallimi: realizim - planifikim 2014	**5.81 %**

Tabela 2.2

- Ndërsa reflektimi financiar i transportit të udhëtarëve, siç mund të shihet nga shënimet më lart në këtë periudhë kohore, është 3.03 % më shumë se sa vitin e kaluar për të njëjtën periudhë dhe rreth **5.81** % më shumë sesa planifikimi i paraparë për këtë periudhë.




Figura 2.1

Të hyrat dhe shpenzimet nga transporti i udhëtarëve

Përshkrimi - Të hyrat	janar - dhjetor
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - OSHP	1,002,126.66 €
Të hyrat nga transporti i udhëtarëve - MZHE	500,000.00 €
Shitjet nga transporti i udhëtarëve - bileta	240,122.58 €
Transport i organizuar për udhëtarë	10,587.95 €
Total të hyrat	**1,752,837.19 €**
Shpenzimet direkte në transportin e udhëtarëve	1,306,000,75 €
Shpenzimet indirekte në transportin e udhëtarëve	923,668.29 €
Total shpenzimet	**2,229,669.04 €**
Fitimi / humbje operative	- 476,831.85 €
Fitimi / humbje operative në %	**- 21 %**

Tabela 3.3




Figura 2.2

- Siç shihet nga tabela më lart biznesi i transportit të udhëtarëve ka operuar me një humbje operative prej **- 21 %** gjatë periudhës raportuese, duke llogaritur të hyrat nga: OSHP, MZHE-ja si dhe të hyrave nga shitja e biletave të udhëtarëve dhe transporteve të kontraktuara.

Vërejtje:

- *Shpenzimet indirekte janë përllogaritur në bazë të përqindjes së operimit të trenave për këtë periudhë një vjeçare duke marrë për bazë tren-kilometrat, ku ka rezultuar se trenat e udhëtarëve kanë operuar rreth **71** % nga totali i tren-kilometrave që kanë operuar të gjithë trenat.*

- **Sektori i Mirëmbajtjes**

- Në këtë pjesë të raportit do të paraqesim performancen gjatë periudhës janar - dhjetor 2014, duke prezantuar realizimin aktual gjatë kësaj periudhe dhe duke krahasuar me realizimin e vitit paraprak – 2013.

- Në fushën e Sektorit të mirëmbajtjes së: Trenave Motorikë, Lokomotivave, Lokomotivave Manovruese, Vagonëve për transportin e Udhëtareve si dhe Vagonëve për transportin e Mallrave gjatë periudhës kohore të raportimit janar - dhjetor 2014 kemi pasur këto rezultate;

- Matja e produktivitetit në shfrytëzimin e fuqisë punëtore
- Matja e shfrytëzimit të fuqisë punëtore tregon se sa dhe ku shfrytëzohet më tepër fuqia punëtore dhe tregon raportin në mes fuqisë punëtore në dispozicion dhe fuqisë punëtore të shfrytëzuar
- Shërbimi i mirëmbajtjes së lokomotivave gjatë periudhës janar-dhjetor ka disponua me fuqi pune prej **18,577.5** orë ku:
  - **106,958.00** orë, janë shfrytëzua për riparim apo **57.57 %** e fondit total të orëve
  - **2,938.00** orë, janë shfrytëzua për punë ndihmëse dhe dytësore apo **15.81 %** e fondit total të orëve
  - Produktiviteti i tërë ka qenë **73.38 %**
- Shërbimi i mirëmbajtjes se vagonëve gjatë periudhës janar - dhjetor ka disponua me fuqi pune prej **13,801.5** orë ku:
  - **7,272.50** orë, janë shfrytëzua për riparim apo **52.69** % e fondit total të orëve
  - **1,388. 00** orë, janë shfrytëzua për pune ndihmese dhe dytësore apo **10.06 %** e fondit total të orëve
  - Produktiviteti i tërë ka qenë **62.75**

3.4. PASQYRA E PERFORMANCËS FINANCIARE DHE REZULTATET

TREGUESIT E RAPORTIT FINANCIAR

1. Gjendja financiare janar – dhjetor 2014
2. Gjendja në para të gatshme - raporti sipas bankës (31.12.2014)

1. Gjendja financiare janar - dhjetor 2013

Për periudhën raportuese janar – dhjetor 2014, kemi një gjendje të kënaqshme financiare dhe operative. Gjendja e pozicioneve të të hyrave dhe shpenzime është siç vijon:

TË HYRAT

Nga **Transporti i mallrave** kemi realizuar të hyrat prej 2,496,759.00€ për periudhën janar - dhjetor 2014. Totali i të hyrave të planifikuara për vitin 2014 është 2,551,770.42€ dhe nga kjo rrjedh se kemi realizuar 97.84% nga totali i planifikuar për tërë vitin 2014.

Të hyrat nga transporti i mallrave eksport/import janë realizuar sipas kategorive që pasojnë: të hyrat nga importi i kemi realizuar përmes vijës kufitare Hani i Elezit janë 1,188,278.07€ dhe nga eksporti përmes vijës kufitare Hani i Elezit kemi realizuar shumën prej 83,929.85€. Transporti i brendshëm kryesisht është realizuar për "New Co Ferronikeli" dhe atë në transportin e xehes nga Medveci dhe thëngjillit nga Kastrioti. Në këtë periudhë nga ky lloj i transportit është realizuar shuma prej 1,224,551.08€.

Për të prezantuar të hyrat në total sipas linjave të realizuara për transportin e mallrave hyjnë: transporti i mallrave i ndarë sipas klasave (i prezantuar më lart), të hyrat nga kontejnerët. Të hyrat nga RIV-i dhe nga vendosja (janë të specifikuara në pozicionin të hyrat nga shërbimet tjera).

Transporti i udhëtarëve për periudhën janar – dhjetor 2014 është realizuar në shumën prej 1,752,837.19€. Nga të hyrat e faturuara nga Transporti i Kontraktuar janë 1,002,126.66€, nga të hyrat e planifikuara nga MZHE për mbulimin e pjesshëm të humbjeve nga trenat tjerë të udhëtarëve kemi realizuar shumën prej 500,000.00€. Burimi i të ardhurave nga biletat dhe të hyrat tjera është realizuar në shumën prej 240,122.58€ dhe nga transporti i organizuar 10,587.95€. Shprehur në përqindje me realizimin e të hyrave nga transporti i udhëtarëve kemi arritur shumën e realizimit prej 88.64% krahasuar me planifikimet për tërë vitin 2014.

Të hyrat nga shërbimet tjera gjatë periudhës janar - dhjetor 2014 kanë arritur shumën prej 169,194.93€. Kjo shumë nëse krahasohet me shumën e buxhetuar për vitin 2014 e cila është 189,686.68€ arrin kuotën prej 89.20%. Kjo e hyrë është realizuar në pozicionet siç vijojnë: Të hyrat e tjera nga kontejnerët dhe shërbimi për ta – 82,060.00€ dhe të hyrat nga RIV-i dhe vendosjet – 87,134.93€.

Të hyrat nga dëmtimi i vagonëve 125,791.18.

Të ardhura tjera jo operative - janë 67,849.85€.

Shuma e **Donacionit nga Buxheti i Kosovës** prej 1,238,842.00€ për projektet kapitale të parashikuara në vitin 2014, nuk është shpenzuar për arsye të procedurave të tenderimit.

SHPENZIMET

Shpenzimet për periudhën janar - dhjetor 2014, edhe pse kemi tejkalim të planifikimeve operative, shpenzimet janë brenda kufijve të planifikimit ashtu edhe siç janë buxhetuar janë të klasifikuara në kategoritë që pasojnë:

Totali i kostos së shërbimit për periudhën është 2,188,752.61€ nga 2,748,278.68€ të planifikuara për vitin 2014 dhe arrijnë kuotën prej 79.64%. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën më poshtë – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2014

Shpenzimet e stafit është kategori tjetër e rëndësishme e cila ka arritur shumën prej 1,569,621.61€, dhe atë në paga dhe kontribute – 1,554,875.01€ dhe sigurimi shëndetësor, trajnime dhe shpenzime tjera – 14,746.60€. Në total nëse e krahasojmë periudhën janar – dhjetor me shumën e buxhetuar për tërë vitin në këtë kategori kemi arritur kuotën prej 103.69%.

Totali i shpenzimeve operative kap shumën prej 206,031.27€, kjo shumë është vetëm 80.83% nga shuma prej 254,695.44€ e parashikuar për vitin 2014. Edhe kjo kategori e shpenzimeve sipas grupimeve në kode të posaçme është e precizuar në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2014.

Totali i shpenzimeve administrative ka arritur në kuotën prej 53.37%, konkretisht në shumën prej 82,987.51€. Planifikimi vjetor i kësaj kategorie është 156,190.76€. Shpenzimet sipas grupimeve në kode të posaçme janë të precizuara në tabelën e mëposhtme – të hyrat dhe shpenzimet operative për periudhën janar – dhjetor 2014.

TABELA 1. TË HYRAT DHE SHPENZIMET OPERATIVE PËR PERIUDHËN JANAR – DHJETOR 2014

	EMËRTIMI	Realizimi Janar-Dhjetor 2014	Buxheti i Planifikuar 2014	Diferenca	B/C (%)	Realizimi Janar – Dhjetor 2013
	A	B	C	D	E	F
A	Shitjet					
1	Transporti i mallrave	2,496,759.00	2,551,770	-55,011.00	97.84	3,049,047.22
2	Transporti i udhëtarëve	1,752,837.19	1,977,442.89	-224,605.70	88.64	1,738,046.46
3	Shërbimet tjera	169,194.93	189,686.68	-20,491.75	89.20	164,118.54
4	Të hyrat tjera jo operative	67,849.85		67,849.85		181,248.09
I	TOTAL – TË HYRAT	4,486,640.97	4,718,899.99	-232,259.02	95.08	5,132,460.31
B	Kostoja e shërbimit/blerjes së					


	materialeve					
1	Derivatet dhe lubrifikuesit	925,340.15	1,251,500.00	-326,159.85	73.94	1,264,538.25
2	Energjia elektrike dhe shërbimet tjera komunale	62,493.15	69,164.44	-6,671.29	90.35	30,168.73
3	Inventar dhe pajisje	181.13	51,000.00	-50,818.87	0.36	570.7
4	Material harxhues	17.24	5,300.00	-5,282.76	0.33	0.00
5	Pjesë rezervë/mirëmbajtje dhe materiale tjera	50,501.17	122,114.24	-71,613.07	41.36	98,473.30
6	Qasja në binarë	857,546.64	1,015,700.00	-158,153.36	84.43	804,494.94
7	Sigurimi i palëve të treta	5,570.69	13,000.00	-7,429.31	42.85	5,549.14
8	Tërheqja e trenave dhe qiraja e vagonëve të huaj	213,738.16	215,500.00	-1,761.84	99.18	250,595.73
9	Shpenzimet e trans.biletave dhe KMSH Infrakos	72,827.19	5,000.00	67,827.19	1,456.54	65,730.55
10	Blerje/shpenzime të tjera	537.09	0.00	537.09		6,033.63
	TOTAL – KOSTOJA E SHERBIMIT	2,188,752.61	2,748,278.68	-559,526.07	79.64	2,526,154.97
	Fitimi (humbja) bruto	2,297,888.36	1,970,621.31	327,267.05	116.61	3,382,877.18
C	Shpenzimet e stafit					
1	Pagat dhe kontributet	1,554,875.01	1,455,750.00	99,125.01	106.81	1,487,011.94
	Sigurimi shëndetësor, trajnime dhe Shpenzime tjera	14,746.60	58,000.00	-43,253.40	25.43	17,911.95
	TOTAL - Shpenzimet e stafit	1,569,621.61	1,513,750.00	55,871.61	103.69	1,504,923.89
D	Shpenzimet operative					
1	Mirëmbajtja dhe riparimi i objekteve	5,797.18	17,650.00	-11,852.82	32.84	923.86
2	Sigurimi fizik – total	34,209.78	45,000.00	-10,790.22	76.02	39,711.20
3	Shërbimet tjera	64.50	3,000.00	-2,935.50	2.15	0.00
4	Shpenzimet logjistike	28,206.38	60,668.00	-32,461.62	46.49	38,385.50
5	Energjia elektrike dhe shërbimet komunale	9,658.49	10,693.20	-1,034.71	90.32	40,467.61
6	Sigurimi i palëve të treta	4,049.78	10,000.00	-5,950.22	40.50	3,090.82
7	Donacionet e dhëna	800.00	800.00	0.00	100.00	1,300.00
8	Marketingu	10,034.74	23,000.00	-12,965.26	43.63	2,747.76
9	Udhëtimet zyrtare	15,264.43	30,000.00	-14,735.57	50.88	20,595.00
10	Telefonat dhe Posta	21,709.52	28,352.24	-6,642.72	76.57	19,781.08
11	Shërbimet bankare	1,666.75	3,000.00	-1,333.25	55.56	1,964.98
12	Tatimet	5,016.85	5,000.00	16.85	100.34	1,390.44
13	Pajisje elektronike	10,853.51	17,532.00	-6,678.49	61.91	14,165.62
14	Zbritjet e Lejuara	58,699.36		58,699.36		15,675.03
	TOTAL - Shpenzimet operative	206,031.27	254,695.44	-48,664.17	80.83	200,198.90
E	Shpenzimet administrative					

1	Mbeturinat dhe shërbimet komunale					
2	Inventar dhe pajisje	8,477.59	9,000.00	-522.41	94.20	152.29
3	Konsulenca dhe auditimi i jashtëm	10,758.60	14,500.00	-3,741.40	74,20	0.00
4	Material i zyrës	9,329.64	14,220.00	-4,890.36	65.61	12,901.19
5	Material sanitar	9,364.35	13,000.00	-3,635.65	72.03	2,119.22
6	Qiraja për objektet	9,554.45	11,000.00	-1,445.55	86.86	6,409.01
7	Reprezentacioni dhe bufeja	12,398.78	13,780.00	-1,381.22	89.98	9,501.68
8	Shpenzimet gjyqësore dhe ndëshkimet	4,359.68	15,000.00	-10,640.32	29.06	9,372.70
9	Shpenzimet logjistike	4,196.04	15,700.00	-11,503.96	26.73	4,109.97
10	Kontingjente	14,548.38	49,990.76	-35,442.38	30.22	22,993.34
	TOTAL - shpenzimet administrative	82,987.51	156,190.76	-73,203.25	53.37	67,559.40
II	TOTAL -SHPENZIMET (B+C+D+E)	4,047,393.00	4,672,914.88	-625,521.88	86.61	4,298,837.16
III	Fitimi (Humbja) para zhvlerësimit	439,247.97	45,985.2	393,262.77	955.19	833,623.15
	Te Ardhura nga Grantet	808,157.85	776,571.84	31,586.01	104.07	776,571.84
F	Shpenzimet e zhvlerësimit					
1	Shpenz. e zhvl. që ndikojnë në koston e shërbimit	808,157.85	776,571.04	287,903.25	104.07	776,571.84
2	Shpenzimet e zhvlerësimit që nuk ndikojnë në koston e shërbimit	157,053.50	79,731.32	77,322.18	196.97	79,731.32
	TOTAL - shpenzimet e zhvlerësimit	965,211.35	856,303.16	108,908.13	112.71	856,303.16
G	Fitimi (humbja) nga veprimtaria	282,194.47	-33,746.12	315,940.59	836.22	753,891.83


Vërejtje:

Sa i përket realizimit të planit të biznesit për vitin 2014 Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A kanë pasur të planifikuar një buxhet operativ në vlera prej 2,977,592.15, ndërsa realizimi operativ në vitin 2014 ka arritur shumën në vlera prej 2,984,514.31, që do të thotë se realizimi është më shumë se planifikimi për 6,922.16. Ndërsa mos realizimi në të hyra totale ka ndodhur si rezultat i zvogëlimit të të hyrave nga Ministria e Infrastrukturës të cilat kanë qenë të planifikuara në vlerën prej 1,241,307.84€ ndërsa janë realizuar të hyra në vlerë prej 1,002,126.66 €, *apo 239,181.20 € më pak edhe pse këto të hyra nuk i mbulojnë humbjet që na shkakton transporti i udhëtarëve ku me Ligjin Nr. 04/L-063 për Hekurudhat Kosovës, kjo ministri është e obliguar të bëjë mbulimin e këtyre shpenzimeve.*

Diagrami 1 – Pjesëmarrja e të hyrave sipas llojit të shërbimit janar – dhjetor 2014



Diagrami 2 – Pjesëmarrja e shpenzimeve sipas kategorive janar – dhjetor 2014



3 Gjendja në para të gatshme – Raporti sipas bankës (31.12.2014)

Nr	EMËRTIMI	Saldo 31-12-14
	PCB nr. 1114-004229-0001-59	373,753.33
	PCB (KTh) nr. 1114-004229-0101-50	24,989.00
	BKK - PCB (K) nr. 1114-004229-0201-41	131,262.57
	BKK - PCB (S) nr. 1114-004229-0301-32	230,965.79
	BKK - PCB (M) nr. 1114-004229-0401-23	255,101.73
	Totali	**1,016,072.42**

BILANCI I GJENDJES		
NP TRAINKOS SH.A	**GJENDJA FILLESTARE 01/01/14**	**GJENDJA PERFU. 31/12/2014**
Mjetet themelore - vlera neto sipas librave	**7,983,107.48**	**7,083,624.12**
Mjetet Qarkulluese	**3,131,320.65**	**3,612,572.89**
Stoqet	549,457.75	576,235.83
Paraja	597,734.22	1,018,323.77
Llogarite e arketueshme	1,922,226.68	1,904,991.81
Kerkesa tjera te arketushme	38,158.20	43,086.07
Parapagimet	23,743.80	69,935.41
Total Mjetet Qarkulluese dhe themelore	**11,114,428.13**	**10,696,197.01**
Detyrimet afatshkurta	**477,579.98**	**592,040.92**
Llogarite e pagueshme	431,501.84	561,820.17
Te pagueshme tjera - detyrime	15,277.66	16,097.51
Detyrime tatimore	30,800.48	14,123.24
Llogarite Inter Company		
Detyrimet afatgjata	**4,772,313.30**	**4,719,228.39**
Kapitali	**5,710,634.25**	**5,384,927.70**
Fitimi/Humbja e bartur	153,900.60	153,900.60
Fitim/ Humbja e vitit	0	-367,581.28
Total detyrimet dhe kaptali	**11,114,428.13**	**10,696,197.01**

3.5. PROGRESI ME PLANIN E BIZNESIT

Implementimi i Planit të Biznesit për Vitin 2014 në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh.A filloi me mjaft vështirësi për shkak të gjendjes së trashëguar.

Duke ju referuar të hyrave me planin operativ për vitin 2014 përkundër vështirësive të theksuara më lart ne kemi arritur rezultate të kënaqshme në raport me planin operativ. Nga një Plan Operativ i cili ka qenë i planifikuar në shumën prej 2,977,592.15 kemi arritur një realizim të plotë të buxhetit operativ si dhe tejkalim apo shprehur në shuma totale në vlerë prej 2,984,514.31. Nga kjo mund të konstatojmë se progresi me planin e biznesit është realizuar 100% nga ajo qe është planifikuar, andaj Hekurudhat e Kosoves - Trainkos Sh.A po e mbyllin një vit të suksesshëm në raport me Planin e Biznesit për vitin 2014.

3.6. PROJEKTET KAPITALE TË TRAINKOS SH.A

Titulli i Aktivitetit te Prokurimit	Data e nenshkrimit te kontrates	Buxheti i zotuar	Vlera e kontrates	Koment
Shërbimet e sigurimit fizik	05.03.2014	45,000.00	26,671.00	Përfunduar
Furnizimi me gjenerator	03.04.2014	9,980.00	9,900.00	Përfunduar
Furnizimi me koka cilindrike	26.12.2014	60,000.00	59,271.60	Përfunduar
Furnizimi me rroba mbrojtëse	13.05.2014	24,000.00	18,979.00	Përfunduar
Shërbimet e sigurimit te veturave	15.12.2014	6,500.00	6,452.00	Përfunduar
Furnizimi me ndërruesin e shpejtësive për dizel motor Perkins tip 1106	23.12.2014	9,900.00	9,855.00	Përfunduar
Furnizimi me derivate te naftës	05.01.2014	1,200,000.00	900,025.00	Përfunduar
Furnizimi me filtra për motor 710	05.06.2014	6,000.00	5,405.00	Përfunduar
Furnizim me material elektrik	06.02.2014	2,800.00	2,450.00	Përfunduar
Furnizimi me shpejtësimatës digjital për lokomotiva	16.08.2014	8,000.00	7,047.80	Përfunduar
Furnizimi me bllomba	13.10.2014	2,000.00	892.00	Përfunduar
Furnizimi me fotokopje	04.11.2014	5,000.00	4,976.00	Përfunduar
Furnizimi me material higjenik	08.12.2014	8,000.00	7,988.00	Përfunduar
Furnizimi me dhurata te fundvitit	09.12.2014	9,700.00	9,300.00	Përfunduar
Dezinfektimi I objekteve	01.12.2014	6,000.00	5,985.00	Përfunduar
Auditimi i pasqyrave financiare	12.01.2015	5,000.00	4,950.00	Përfunduar
Furnizimi me kompjuterë	09.12.2014	2,422.00	2,500.00	Përfunduar
Furnizimi me thëngjill	29.10.2014	15,500.00	15,041.00	Përfunduar
Kontrolli sistematik i punëtorëve	01.12.2014	5,000.00	5,000.00	Përfunduar
Furnizim me pjese dhe material të ndryshëm për të gjithë sektorët	Te ndryshme	35,000.00	34,273.01	Përfunduar

3.7. PRERSPEKTIVA PËR VITIN E ARDHSHËM

Më poshtë janë të paraqitura objektivat tona ekonomike për vitin 2015.

- ✓ Ngritja e vazhdueshme e kapaciteteve të resurseve njerëzore;
- ✓ Ngritja e një bashkëpunimi të qëndrueshëm me operatorët rajonal dhe atyre nga vendet e BE-së në transportin hekurudhor me qëllim të shkëmbimit të përvojave të suksesshme;
- ✓ Të rrisim shërbimet dhe cilësinë e tyre në transportin hekurudhor, për një zhvillim të vazhdueshëm të ndërmarrjes;
- ✓ Të pasurojmë parkun e mjeteve lëvizëse;
- ✓ Objektivi në tregun e transportit të udhëtarëve është që të kemi një ngritje prej 1 % krahasuar me planifikimin e vitit 2014;
- ✓ Në shërbimin e mirëmbajtjes së vagonëve të kemi një rritje prej 3 % në krahasim me planifikimin për 2014;
- ✓ Rritja në transportin e mallrave për 4 % më shumë se planifikimi për vitin 2014;
- ✓ Niveli i inkasimit të borxheve (arkëtueshmeve) të mëparshme të jetë > 10 %.
- ✓ Rritja e nivelit profesional-shkollime profesionale
- ✓ Krijimi i kushteve më të mira për punë
- ✓ Ngritja e sigurisë në komunikacionin hekurudhor;
- ✓ Ngritja e efikasitetit në realizimin e projekteve;
- ✓ Përmirësimi i nivelit të shërbimeve;
- ✓ Përmirësimi i komoditetit për udhëtarët;
- ✓ Përmirësimi i strukturës gjinore;
- ✓ Promovimi i shërbimeve tona në nivel gjithëpërfshirës;
- ✓ Hulumtimi i tregut dhe kuptimi më i mirë i kërkesave në treg;
- ✓ Përmirësimi i sistemit të komunikimit brenda dhe me klientë;
- ✓ Rritja e efektivitetit në dhënien e shërbimeve;
- ✓ Ndryshimi i kulturës biznesore të punonjësve të kompanisë bazuar në të arriturat e reja teknologjike;

3.8. RREZIQET E SË ARDHMES SË KORPORATËS

Në këtë pjesë kemi paraqitur disa nga rreziqet të cilat po na përcjellin nga viti në vit të cilat dhe i kanosen kompanisë sonë në të ardhmen për të cilat duhet punuar që t'i minimizojmë efektet e tyre:


- Numri i vogël i mjeteve lëvizëse dhe vjetërsia e tyre;
- Mosmbulimi i shpenzimeve të Transportit të Udhëtarëve sipas Ligjit për Hekurudhat e Kosovës ;
- Buxheti i vogël për investime kapitale dhe kostoja e lartë e investimeve në mjetet lëvizëse;
- Kontestet e shumta gjyqësore të trashëguara nga ish-Hekurudhat;
- Pamundësia e kontrollit të procesit të ofrimit të shërbimit për transportimin e mallrave të importuara apo të eksportuara vetëm nga ana jonë për shkak të përfshirjes të më shumë operatorëve hekurudhorë në ofrimin e këtij shërbimi;
- Gjendja jo e mirë e infrastrukturës hekurudhore dhe kufizimet që shkaktohen në operim qoftë në aspektin e shpejtësisë ashtu edhe në operimin 24/7;
- Futja e operatorëve të rinj në treg;
- Obstruksionet e vazhdueshme nga Hekurudhat Serbe dhe bllokimi i daljes veriore për në Serbi përmes së cilës do të lidheshim me shtetet tjera të Evropës, por edhe me porte tjera detare.

4 RAPORTI SIPAS LIGJIT PËR NDËRMARRJET PUBLIKE

4.1. STRUKTURA ORGANIZATIVE E TRAINKOS SH.A

Skema organizative e Trainkos Sh.A

Operimi me trena në Hekurudhat e Kosovës Trainkos Sh.A vitin 2014 e ka filluar me një strukturë më të konsoliduar se në vitin 2013. Potenciali njerëzor i punonjësve në fillim të vitit 2014 ka qenë i sistemuar në bazë të përgatitjes së tyre dhe nevojave që ka kërkuar vetë procesi i punës. Shpërndarjes dhe sistemimit të tyre i ka paraprirë skema organizative e kompanisë e cila është ndërtuar në bazë të nevojave të punës të cilën do ta paraqesim në vijim:



Paraqitja statistikore për llojet e kontratave, mosha e të punësuarve, struktura gjinore, struktura nacionale dhe kualifikimi shkollor i të punësuarve në Trainkos Sh.A është si vijon:

Struktura e të punësuarve në bazë të kategorizimeve të Trainkos Sh.A më 1 Janar 2014 dhe më 31 Dhjetor 2014					
Totali i të punësuarëve	01.01.2014		31 .12.2014		
	220		224		
Vlerat	Vlerat në numra		Vlerat në përqindje		
Datat	01.01.2014	31.12.2014	01.01.2014	31.12.2014	
Mosha mesatare e punëtorëve	47.00	46.37	%	%	
Me marrëdhënie të rregullt pune	220	224	%	%	Format e kontratavee
Me kontratë të paafatizuar	83	76	37.73 %	33.93 %	
Me kontratë të afatizuar	137	148	62.27 %	66.07 %	
Meshkuj	198	201	90.00 %	89.73 %	Gjinia
Femra	22	23	10.00 %	10.27 %	
Serb	2	2	0.90 %	0.90 %	Nacionalitet
Shqiptarë	218	222	99.09 %	99.11 %	
Me shkollim fillor	18	17	8.18%	7.58 %	Shkollimi
Me shkollim të mesëm	155	157	70.45%	70.08 %	
Me shkollim të lartë	4	4	1.81%	1.78 %	
`Me shkollim superior	43	46	19.54%	20.53 %	
Departamenti i Operimeve	140	138	63.64 %	61.61 %	Përshkrimi i Departamenteve
Departamenti i Administratës	42	43	19.09 %	19.20 %	
Departamenti i Fianancave	6	8	2.73 %	3.57 %	
Departamenti i Zhvillimit të Biznesit	6	7	2.73 %	3.13 %	
Kabineti i KE-së	6	7	2.73 %	3.13 %	Kabineti i KE-së dhe Zyret në kuadër të KE-
Zyra e Kontrollit, Sigurisë dhe Kualitetit	14	15	6.36 %	6.70 %	
Zyra për Marrëdhënie me Publikun	3	3	1.36 %	1.34 %	
Zyra e Prokurimit	3	3	1.36 %	1.34 %	

Sqarim: *Gjatë periudhës janar-dhjetor 2014 kemi pasur 12 punësime, 7 pensionime, 1 ndërprerje të një anshme të marrëdhënies së punës, 2 punëtorë të vdekur. Gjatë vitit 2014 kemi pasur 8 punëtorë me kontratë për punë specifike, të cilët nuk janë përfshirë në tabelën më lart. Po ashtu në këtë tabelë nuk janë përfshirë as anëtarët e Bordit të Drejtorëve.*

4.2. KONTESTET GJYQËSORE NË PERIUDHËN JANAR-DHJETOR 2014

Gjatë periudhës njëvjeçare Departamenti i Administratës/Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore ka mbajtur gjithsej 72 seanca gjyqësore. Kontestet Gjyqësore janë një ndër rreziqet kryesore të kompanisë, sidomos kontestet e punës.

Këto procese janë të trashëguara nga ish-Hekurudhat e Kosovës si rezultat edhe i mos përfilljes së procedurave dhe kontratave nga menaxhmenti i asaj kohe. Me qëllim të përfaqësimit, ruajtjes dhe mbrojtjes së interesave të kompanisë. Duke u bazuar në aktet normative të aplikueshme në Hekurudhat e Kosovës - Trainkos Sh A si dhe në propozimin e nxjerrjes së provave përmes ekspertizave dhe super ekspertizave në rastet e mungesës së disa provave me qëllim të konstatimit të përgjegjësisë-kontributit të pjesëmarrësve në komunikacionin hekurudhor dhe zgjidhjes së këtyre kontesteve në favor të kompanisë Sektori për Çështje Ligjore dhe Resurse Njerëzore ka ndërmarr të gjitha veprimet në sigurimin e të gjitha provave elementare për ta mbrojtur kompaninë nga paditësit që kanë ngritur padi kundër Hekurudhave e Kosovës - Trainkos Sh A për kompensimin e dëmeve materiale dhe jo materiale. Të gjitha këto aspekte janë trajtuar në mënyrë të përgjegjshme dhe profesionale nga zyrtarët ligjorë të Kompanisë.

4.3. KONTESTET GJYQËSORE TË PRITURA NË VITIN 2015

Hekurudhat e Kosovës Trainkos SH.A në vitin 2015 pritet të ballafaqohen me 51 konteste gjyqësore që nga procedura fillestare e deri te revizioni. Në tabelën më poshtë është pasqyruar numri i kontesteve të hapura dhe kategorizimi i tyre për të cilat mund të kemi ftesë nga gjykatat gjatë vitit 2015:

Kategoritë e kontesteve	
Kontestet nga marrëdhënia e punës	14
Kontestet për kompensim të dëmit	24
Kontestet për pagim të borxhit	9
Penale	4

Në bazë të kësaj gjendje, kontestet gjyqësore mbesin si një ndër rreziqet më të mëdha të kompanisë pasi që kontestet gjyqësore janë në numër shumë të madh si dhe me një vlera të larta financiare. Në rast të humbjes të ndonjë kontesti kompania do të dëmtohet financiarisht. Kontestet janë si rrjedhojë e menaxhimit jo të mirë të kompanisë sa ishte nën administrim të UNMIK-ut dhe një pjesë e madhe edhe pas daljes së kompanisë nga administrimi I UNMIK-ut.

- **kontestet nga marrëdhënia e punës**

Gjatë vitit 2015 nga kontestet e marrëdhënies së punës në procedurë gjyqësore do të jenë 14, prej të cilave në shkallë të parë për momentin gjenden 5 konteste kurse në shkallën e dytë gjenden 8 konteste dhe një kontest në shkallën e tretë.

- **kontestet për kompensim dëmi**

Nga kontestet për kompensim të dëmit gjithësejt në procedurë gjyqësore gjenden 24 konteste.

Gjatë vitit 2015 nga kontestet e kompensimit të dëmit në procedurë gjyqësore në shkallë të parë për momentin kemi 7 konteste ndaj të cilave vazhdon procesi gjyqësor, kurse në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë gjenden në procedurë (shkalla e dytë) 17 konteste.
Vlenë për të theksuar se numri i kontesteve për kompensim dëmi po shtohet dhe kjo mvarsisht nga ndodhja e aksidenteve në komunikacionin hekurudhor .

- **kontestet për pagim të borgjit**

Nga kontestet për pagim borgji gjatë vitit 2015 në procedurë gjyqësore kemi 9 konteste prej të cilave 8 në procedurë në shkallën e parë, kurse 1 në procedurë të përmbarimit N.T.SH.'Ballkan Shped'. Vlenë për të theksuar se numri i kontesteve të borgjit gjatë vitit 2015 do të rritet sepse sektori i financave në Trainkos Sh.a është duke përgatitur Propozimet për inicimin e procedurës gjyqësore ndaj klientëve të cilët nuk kanë përmbush borgjet në bazë të kontratave të transportit të mallrave.

- **lëndët penale**

Nga lëndët penale në procedurë aktualisht kemi 4 lëndë por ky numër do të rritet varësisht nga ftesat që do të vijnë nga gjykata.

Tani nuk mund të supozojmë për sa konteste Gjykata e Apelit të Kosovës do të vendos gjatë vitit 2015 (të gjitha kategoritë e kontesteve), dhe sa konteste do t'i kthej në rigjykim, por kemi theksuar vetëm numrin e kontesteve që gjenden në procedurë gjyqësore.

4.4. TRANSAKSIONET E REALIZUARA JANAR- DHJETOR 2014

Në tabelat në vijim janë paraqitur transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse dhe ato në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës:

Transaksionet e kompanisë në llogaritë rrjedhëse	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2014	**196,054.10 €**
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2014	**3,575,228.53 €**
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2014	**3,752,927.76 €**
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2014	**373,753.33 €**

Transaksionet në projektet kapitale të financuara nga Buxheti i Kosovës	
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 01.01.2014	**138,262.92 €**
Inkasimet e pranuara gjatë muajve janar – dhjetor 2014	**125,000.00 €**
Pagesat e kryera gjatë muajve janar – dhjetor 2014	**132,000.35 €**
Gjendja në llogaritë e kompanisë më 31.12.2014	**131,262.57 €**

5 PËRFUNDIM

Performanca pozitive e Trainkos Sh.A për vitin 2014, pik së pari është rezultat i angazhimit të palodhshëm të të gjithë strukturës organizative të kompanisë duke filluar nga Bordi i Drejtorëve, menaxhmenti dhe deri tek niveli operativ.

Faktorë tjerë që kanë ndikuar në performancën e kompanisë janë gjithashtu politikat e shpenzimeve që ka ndjekur kompania duke u përqendruar vetëm në shpenzimet e nevojshme për operimin. Një faktor mjaft të rëndësishëm mund ta konsiderojmë edhe planifikimin i cili ka qenë i bazuar në parametra të matshëm dhe objektiva reale dhe të arritshme.

Që Trainkos Sh.A të vazhdojë në të ardhmen me operim dhe biznes të suksesshëm nuk mjafton vetëm menaxhimi i mirë nga ana e strukturës organizative. Kompania tani më ka nevojë për investime serioze në flotën e mjeteve lëvizëse, përkundër faktit që në dy vitet e fundit 2013,2014 kemi operuar me fitim, buxheti i vogël i kompanisë duke përfshirë edhe pjesën e ndarë nga aksionari për investime kapitale nuk mjaftojnë për të mbuluar investimet që kërkohen për të garantuar një qëndrueshmëri operative të kompanisë.

Është mëse e nevojshme që aksionari bashkë me strukturat udhëheqëse të kompanisë të ndërtojë një planë të përbashkët për të realizuar këto investime që do të siguronin të ardhme të sigurt biznesore dhe funksionale të kopanisë. Duke pasur parasysh se tanimë pritet që të kemi hapje të linjave të reja të transportit veç sa e rritë nevojën për veprim në këtë aspekt.

Duke qenë se është dëshmuar në të gjitha vendet e zhvilluara dhe atyre në zhvillim se transporti hekurudhor është arteria më e rëndësishme e zhvillimit industrial dhe ekonomik, konsiderojmë se aksionari duhet ta vë në prioritet investimin në këtë sektor duke siguruar qëndrueshmëri për operatorin Trainkos Sh.A.

Mbesim të përkushtuar maksimalisht në angazhimet tona të përditshme për zhvillimin e gjithmbarshëm të kompanisë dhe për ofrimin e shërbimeve sa më të mira për klientët tanë, siç edhe kemi dëshmuar në dy vitet e fundit dhe siç dëshmon ky raport për vitin 2014, ne do të zhvillojmë biznes profitabil për sa kohë nuk kemi ndikimin e faktorëve që janë jashtë mundësive tona. Jemi optimist se më shtimin e linjave të transportit vendor dhe ndërkombëtar dhe më një ofertë të mirë të transportit në të ardhmen do të kemi performanca edhe më të mira.

Fushë Kosovë
13.03.2015

Kryeshef Ekzekutiv i HK-Trainkos Sh.A
Gelor Shala